



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 136/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Tunamar” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-43803-11-18-2019, me objekt: “*Blerje peshore elektronike*”, me fond limit 3.175.000 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.

Ankimues: “Tunamar” sh.p.k.
Rruga “Kadri Hoxha”, Nr pasurie 428/5/4, Kusarth, Elbasan.

Autoriteti kontraktor: Posta Shqiptare sh.a.
Rruga “Reshit Çollaku”, Nr.4, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë në rrugë elektronike dhe me rrugë postare pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, duke mos plotësuar kushtet formale të paraqitjes të ankesës.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 19.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-43803-11-18-2019, me objekt: “*Blerje peshore elektronike*”, me fond limit 3.175.000 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Në datën 24.02.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.03.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton se operatori ekonomik ankimues është skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik ankimues pretendon se në datën 12.03.2020 ka paraqitur në rrugë elektronike në sistemin e prokurimeve elektronike ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Ankimuesi pretendon se në datën 18.03.2020 ka depozituar pranë zyrave postare ankesën përkatëse për këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu, ankimuesi pretendon se nuk ka përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor me nr. 2999/25 prot., datë 08.04.2020, të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 09.04.2020 me nr. 321/2 prot, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar pranë këtij të fundit në datën 24.03.2020, për të cilën autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në datën 27.03.2020 me shkresën nr. 2999/22 prot.

II.7. Në datën 26.03.2020, operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2999/25 prot, datë 08.04.2020, protokolluar me tonën me nr. 321/2 prot, datë 09.04.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së sqaron se:

[...]

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, komisioni i vlerësimit të ofertave bëri këtë renditje përfundimtare të ofertave të rregullta.... Më datë 10.03.2020 është bërë vlerësimi i ofertave të kësaj procedure. Më datë 24.03.2020 ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k. duke pretenduar që është skualifikuar padrejtësisht.

Lidhur me këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor megjithëse ka pezulluar procedurën e prokurimit duke mos kryer asnjë veprim më datë 27.03.2020 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues me përmbajtje si më poshtë:

[...] Vlerësimi i ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike është bërë në datë 10.03.2020 afat në të cilin jeni vënë në dijeni. E drejta e ankimit për dokumentat e tenderit nga operatorët ekonomikë mund të ishte paraqitur pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës nga mbyllja e vlerësimit të ofertave në SPE pra deri në datën 18.03.2020.

Përsa më sipër meqenëse ankesa e paraqitur nga ana juaj pranë autoritetit kontraktor më datë 24.03.2020 (14 ditë pas datës së mbylljes së vlerësimit të ofertave në SPE) është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga ky ligj nuk shqyrtohet nga autoriteti ynë kontraktor [...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 19.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-43803-11-18-2019, me objekt: “Blerje peshore elektronike”, me fond limit 3.175.000 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.

III.1.1. Në datën 24.02.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 10.03.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton se operatori ekonomik ankimues është skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit.

III.1.3. Operatori ekonomik ankimues pretendon se në datën 12.03.2020 ka paraqitur në rrugë elektronike në sistemin e prokurimeve elektronike ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Ankimuesi pretendon se në datën 18.03.2020 ka depozituar pranë zyrave postare ankesën përkatëse për këtë procedurë prokurimi, por pa e vërtetuar me dokument këtë fakt. Gjithashtu, ankimuesi pretendon se nuk ka përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.4. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor me nr. 2999/25 prot., datë 08.04.2020, të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 09.04.2020 me nr. 321/2 prot, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar pranë këtij të fundit në datën 24.03.2020, për të cilën autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në datën 27.03.2020 me shkresën nr. 2999/22 prot. Në kthimin e përgjigjes autoriteti kontraktor thekson se ankesa e protokolluar në datën 24.03.2020 pranë tij, nuk është marrë parasysh pasi është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në nenin 63 të ligjit për prokurimin publik. Referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë KPP-së konstatohet se, ankesa është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 24.03.2020, me nr. 2999/21 prot.

III.1.5. Në datën 26.03.2020, operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës nr.2999/25 prot, datë 08.04.2020, protokolluar me tonën me nr. 321/2 prot, datë 09.04.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së sqaron se:

[...]

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, komisioni i vlerësimit të ofertave bëri këtë renditje përfundimtare të ofertave të rregullta.... Më datë 10.03.2020 është bërë vlerësimi i ofertave të kësaj procedure. Më datë 24.03.2020 ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k. duke pretenduar që është skualifikuar padrejtësisht.

Lidhur me këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor megjithëse ka pezulluar procedurën e prokurimit duke mos kryer asnjë veprim më datë 27.03.2020 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues me përmbajtje si më poshtë:

[...] Vlerësimi i ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike është bërë në datë 10.03.2020 afat në të cilin jeni vënë në dijeni. E drejta e ankimit për dokumentat e tenderit nga operatorët ekonomikë mund të ishte paraqitur pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës nga mbyllja e vlerësimit të ofertave në SPE pra deri në datën 18.03.2020.

Përsa më sipër meqenëse ankesa e paraqitur nga ana juaj pranë autoritetit kontraktor më datë 24.03.2020 (14 ditë pas datës së mbylljes së vlerësimit të ofertave në SPE) është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga ky ligj nuk shqyrtohet nga autoriteti ynë kontraktor [...].

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit në datën 12.03.2020 ka paraqitur ankesë në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor për kundërshtimin e skualifikimit të tij.

Në lidhje me këtë ankesë të paraqitur në rrugë elektronike KPP sqaron se:

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit...”. Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 6, gërma “ç”, përcaktohet se: *“Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit”*. Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike.”*.

III.1.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit me shkrim, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, dorëzimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj., por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se dorëzimi i ankesës me mjete elektronike nuk gjen zbatim në kuptim të LPP-së.

III.1.10. Në nenin 82 pika 1 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk ka depozituar pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në formën e përcaktuar në ligj – formë shkresore, ç’ka rrjedhimisht sjell që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekien e të gjitha shkallëve të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, që referuar nenit 26, pika 3, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kushteve formale të saj.

III.1.11. Për më tej, referuar edhe pretendimit të operatorit ekonomik që ankesa është depozituar në rrugë postare në datën 18.03.2020, e cila sipas dokumentacionit të autoritetit kontraktor rezulton të jetë protokolluar në datën 24.03.2020 pranë këtij të fundit, përveç faktit që nuk është provuar me dokumentacion (dokumentacionin postar) nga ankimuesi i cili në bazë të Kodit të Procedurave Administrative ka barrën e provës të provojë me dokumentacion depozitim e ankesës pranë autoritetit kontraktor, rezulton të jetë dorëzuar jashtë afateve ligjore të parashikuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Madje referuar edhe vetë datës 18.03.2020 të cilën ankimuesi e pretendon si datë të dorëzimit të ankesës në zyrat postare, sërish referuar nenit 63 të ligjit për prokurimin publik, ankesa është jashtë afateve ligjore të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar: *1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëlqen e pretenduar, sipas këtij ligji. 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. 6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.1.13. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pika 3, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kushteve formale të saj.

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

III.1.15. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve të ankimit sipas kushteve formale si edhe afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-43803-11-18-2019, me objekt: “Blerje peshore elektronike”, me fond limit 3.175.000 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 321 Protokolli;

Datë 26.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha